



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT  
SPORTIT DHE RINISË  
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

**VLERËSIMI I ARRITJEVE TË NXËNËSVE  
TË KLASËS SË 5-të**

**TIRANË, 2017**

## Përmbajtja

Hyrje .....	3
1. Përmbledhje .....	4
2. Vlerësimi i arritjeve të nxënësve .....	7
2.1. Kapitulli 1: Objektivat, Metodologjia dhe Instrumentet e Vlerësimit .....	7
2.1.1. Objektivat e Vlerësimit .....	7
2.1.1.1. Vlerësimi i kompetencave në testin e lëndës së Gjuhës Shqipe .....	7
2.1.1.2. Vlerësimi i kompetencave në testin e lëndës së Matematikës .....	8
2.1.1.3. Vlerësimi i kompetencave në testin e lëndës së Diturisë së Natyrës .....	9
2.1.2. Metodologjia dhe instrumentet e vlerësimit .....	10
2.1.2.1. Si u realizua vlerësimi .....	10
2.1.2.2. Pjesëmarrësit në testim .....	10
2.1.2.3. Administrimi i të dhënave .....	11
2.1.2.4. Instrumentet e vlerësimit .....	11
2.2. Kapitulli 2: Arritjet e nxënësve.....	12
2.2.1. Përpunimi i të dhënave dhe interpretimi i treguesve statistikore .....	12
2.2.2. Arritjet e nxënësve në vlerësimin e klasës së 5-të.....	13
2.2.3. Arritjet e nxënësve në testin e Gjuhës Shqipe.....	30
2.2.4. Arritjet e nxënësve në testin e Matematikës .....	38
2.2.5. Arritjet e nxënësve në testin e Diturisë së Natyrës .....	44
3. Aneks: Renditja e shkollave sipas arritjeve mesatare në vlerësim .....	52

## Hyrje

Vlerësimi kombëtar i arritjeve të nxënësve të klasës së pestë të arsimit fillor, synon të japë informacion mbi njohuritë dhe aftësitë që nxënësi merr sot në shkollë. Matja e rezultateve të të nxënit është e nevojshme jo vetëm për të monitoruar suksesin e një sistemi arsimor, por edhe për të përmirësuar cilësinë e arsimit.

Objektivi 4 i Zhvillimit të Qëndrueshëm (Sustainable Development Goals SDG) i vendos cilësinë e arsimit dhe rezultatet e të nxënit si objektiva parësore dhe qendrore. Aksesi, pjesëmarrja në arsim dhe regjistrimi i nxënësve ishin fokusi kryesor i objektivave mijëveçjare të zhvillimit (Millenium Development Goals MDG). Ato vazhdojnë të jenë të rëndësishme edhe sot, pavarësisht se bota vazhdon të jetë shumë larg sigurimit të një arsimimi të barabartë dhe cilësor për të gjithë. Pjesëmarrja në arsim nuk është një qëllim në vetevetë, por ajo që ka rëndësi për njerëzit dhe ekonominë janë aftësitë e fituara nëpërmjet arsimimit. Ato që i bëjnë njerëzit të suksesshëm dhe të aftë në jetën e tyre personale dhe profesionale më shumë sesa kualifikimet e fituara janë pikërisht kompetencat dhe cilësitë që i kanë zhvilluar nëpërmjet shkollimit. Pavarësisht kësaj, kualifikimet janë shumë të rëndësishme në përcaktimin e mirëqenies individuale dhe prosperitetin e shoqërive.<sup>1</sup>

Ky vlerësim është realizuar në nivel kombëtar, me të gjithë nxënësit e arsimit fillor, të regjistruar në klasë të pestë, gjatë vitit akademik 2016-2017. Vlerësimi kombëtar i arritjeve të nxënësve të klasës së pestë synon të kontribuojë në zhvillimin dhe analizën e treguesve sasiorë krahasimorë të vlerësimin të jashtëm të arritjeve të nxënësve të klasës së pestë të arsimit fillor.

Informacioni është i organizuar në mënyrë të tillë që mundëson jo vetëm njohjen e arritjeve të nxënësve në nivel DAR/ZA, por njëkohësisht edhe krahasimin mes tyre. Gjithashtu ky raport synon të japë edhe një krahasim të arritjeve të nxënësve të këtij viti me vitet e mëparshme.

---

<sup>1</sup> PISA 2015 Results, Excellence and Equity in Education, Volume I

## 1. Përmbledhje

Vlerësimi i arritjeve të nxënësve të klasës së pestë të arsimit fillor u rendit në radhën e vlerësimeve kombëtare që para tre vitesh dhe synon të japë informacion mbi njohuritë dhe aftësitë që nxënësi merr sot në shkollë në lëndët: gjuhë shqipe, matematikë dhe dituri natyre.

Vlerësimi kombëtar i nxënësve të klasës së pestë është një vlerësim, në të cilin kanë marrë pjesë të gjithë nxënësit që ndjekin klasën e pestë.

**Tabela 1-1** jep treguesit e popullatës së nxënësve dhe raportet për ndryshoret e përcaktuara qytet/fshat, publike/private. Gjithashtu në tabelë janë pasqyruar edhe të dhënat e vitit paraardhës.

Tabela 1-1: Tregues të popullatës për dy vitet e fundit


	<i>Popullata e plotë e nxënësve të klasës 5 viti shkollor 2015-2016</i>				<i>Popullata e plotë e nxënësve të klasës 5 viti shkollor 2016-2017</i>			
	qytet	fshat	publike	private	qytet	fshat	publike	private
<b>Numri</b>	18830	15010	31706	2134	20154	14594	31968	2780
<b>Gjithsej</b>	<b>33840</b>				<b>34748</b>			
<b>Përqindja</b>	56%	44%	94%	6%	58%	42%	92%	8%

**Tabela 1-2** paraqet treguesit e arritjeve mesatare të nxënësve dhe raportet për ndryshoret e përcaktuara qytet/fshat, femra/meshkuj për dy vitet e fundit.

Nga të dhënat e tabelës **1-2** rezulton se:

- në nivel kombëtar mesatarja e arritjeve të nxënësve të klasës së pestë është **41 pikë**
- arritjet mesatare të nxënësve në qytet janë më të larta se arritjet mesatare të nxënësve fshat
- arritjet mesatare të nxënësve femra janë më të larta se arritjet mesatare të nxënësve meshkuj

## Vlerësimi i arritjeve të nxënësve të klasës së 5-të



Grafiku 1-1: Arritjet mesatare të dy viteve të fundit sipas urbanizimit

Tabela 1-2: Treguesit e arritjeve mesatare të nxënësve

Urbanizimi publike/private	Gjinia	Mesatarja e arritjeve 2016 (testi me 50 pikë)	Mesatarja e arritjeve 2016 (i konvertuar në test me 60 pikë)	Mesatarja e arritjeve 2017 (testi me 60 pikë)
<b>Total</b>		<b>33.63</b>	<b>40.35</b>	<b>41.00</b>
	Femra	34.66	41.59	48.93
	Meshkuj	32.68	39.22	39.58
<b>Fshat</b>		<b>30.68</b>	<b>36.81</b>	<b>35.97</b>
	Femra	31.79	38.19	39.32
	Meshkuj	29.7	35.64	35.97
<b>Qytet</b>		<b>36.04</b>	<b>43.25</b>	<b>42.46</b>
	Femra	37.02	44.42	45.21
	Meshkuj	35.14	42.17	42.46

### Gjetje të vlerësimit kombëtar:

- Arritjet e nxënësve në vlerësimin kombëtar të klasës së 5-të janë mbi nivelin mesatar të arritjeve. Vetëm rreth **7.31 % e nxënësve zotërojnë njohuri të nivelit të lartë dhe 0.80 % e tyre zotërojnë njohuri që i përkasin nivelit shumë të ulët.**
- Duke u krahasuar me vitin paraardhës, kemi një rritje me **1.89 %**, të nxënësve që i përkasin nivelit të tretë. **Po ashtu edhe përqindja e nxënësve me arritje mesatare ka pasur një rritje të konsiderueshme me rreth 30%.**
- Nxënësit preferojnë të përzgjedhin mes përgjigjeve të gatshme, se sa ta modelojnë/ndërtojnë vetë atë (përgjigjen). Në këtë rast ka dy probleme që lidhen me: aftësinë e të kuptuarit dhe aftësinë e të shprehurit.

## Vlerësimi i arritjeve të nxënësve të klasës së 5-të

---

- Përqendrimi i punës së mësuesit është kryesisht në nivelet e para të kompetencave, pra riprodhim, njohje dhe kuptim të tekstit dhe pak ose aspak i vënë nxënësit në situatë reflektimi dhe vlerësimi dhe thuajse asnjëherë të merren me fragmente tekstesh të panjohura më parë. Kjo sjell që pak nxënës aftësohen në nivele të larta ku kërkohet mendimi kritik, arsyetimi, interpretimi dhe përgjigjja personale.
- Rezultatet lidhen me punën e pakët që zhvillohet me nxënësit në drejtim të aftësisë së të shkruarit. Qëllimi i lëndës së gjuhës shqipe është që t'i aftësojë nxënësit të shprehen dhe shkruajnë idetë e tyre në lidhje me tema të caktuara dhe jo thjesht të mbartin aftësi mekanike që shfaqen vetëm në zgjidhje fragmentare ushtrimesh.
- Në matematikë, njohuritë gjeometrike, shtrimi i problemave dhe zgjidhja e tyre janë aftësi që nuk zotërohen mirë nga nxënësit.
- Vajzat kanë arritje më të larta, krahasuar me arritjet e djemve.
- Arritjet e nxënësve të qytetit janë më të larta se arritjet e nxënësve në fshat.
- Arritjet e nxënësve në shkollat private janë më të larta se arritjet e nxënësve në shkollat publike. Niveli social-ekonomik i familjeve të nxënësve, numri i nxënësve në klasë, janë ndër faktorët kryesorë që ndikojnë në këtë gjetje të vlerësimit kombëtar.
- Pjesa më e madhe e nxënësve nuk arrijnë të bëjnë një lexim të qëllimshëm të pjesës për të identifikuar një personazh, veçori, veprim, etj., edhe në rastet kur ato jepen drejtpërsëdrejti në tekst. Kjo mund të vijë si pasojë se punojnë pak për të kuptuar fillimisht kërkesën e pyetjes, e më tej të punojnë me tekstin. Realizimi i kërkesave të këtij lloji vetëm nga një pjesë e nxënësve lidhet më së shumti me metodologjinë e zbatuar nga mësuesi gjatë procesit të nxënies .
- Nxënësit kanë vështirësi në përcaktimin e kategorive gramatikore të pjesëve të ndryshme të ligjëratës: emër, mbiemër, folje apo me grupet emërore dhe foljore.
- Në dituri natyre, nxënësit kanë arritur rezultate më të mira kryesisht në pyetje të nivelit të njohjes dhe të kuptuarit. Ndërsa në pyetje të nivelit të lartë, ku nxënësit duhet të vënë në zbatim njohuritë e marra deri më tani, rezultatet janë më të ulta. Kjo do të thotë se mësuesit e ciklit fillor duhet të ushtrojnë eksperimentet në klasë së bashku me nxënësit, pasi në këtë mënyrë nxënësi nxë më shumë duke punuar vetë sesa duke dëgjuar, apo duke parë të tjerët. Gjithashtu në orë të caktuara, mësimi duhet të zhvillohet në natyrë, pasi vetëm aty procesi i mësimdhënies dhe të nxënies bëhet më konkret.
- Një pjesë e mirë e nxënësve shfaqin vështirësi në veprimet me njësitë e njohura të gjatësisë, masës dhe në kryerjen e veprimeve të thjeshta me to. Pjesa më e madhe janë të prirur për të dhënë përgjigje në ato ushtrime, ku mund të kryejnë veprime mekanike dhe jo në të tjerat ku kërkohet arsyetimi logjik.

- Nxënësit duhet të aftësohen në nivele të larta të kompetencave, ku kërkohet mendimi kritik, arsytimi, interpretimi, përgjigjja personale, zgjidhja problemore.
- Nevojitet hartimi i programeve trajnuese që lidhen me strategji të procesit të të nxënësve dhe të vlerësimit të arritjeve të nxënësve.
- Rikonceptim i tekstit të nxënësit në lidhje me mënyrën se si duhet t'u mësohen kompetencat.
- Të përcaktohet qartazi niveli bazë i kompetencave gjuhësore që duhet të zotërojë çdo nxënës në përfundim të arsimit fillor.
- Mësuesi duhet ta orientojë orën e mësimin në zhvillimin e veprimtarive praktike, me qëllim që nxënësi të nxërë duke punuar.

## **2. Vlerësimi i arritjeve të nxënësve**

### **2.1. Kapitulli 1: Objektivat, Metodologjia dhe Instrumentet e Vlerësimit**

#### **2.1.1. Objektivat e Vlerësimit**

Vlerësimi kombëtar i arritjeve të nxënësve në klasën e 5-të, të arsimit të detyruar synon të vlerësojë njohuritë dhe kompetencat bazë, të fituara nga nxënësit në ciklin fillor, në lëndët gjuhë shqipe, matematikë dhe dituri natyre në përfundim të vitit shkollor 2016-2017. Njëkohësisht, ky vlerësim kombëtar synon të vlerësojë aftësitë e nxënësve për të mbajtur qëndrime aktive ndaj njohurive dhe përvojës së fituar në shkollë, si dhe për të parë nevojat për ndërhyrje apo përmirësime të mëtejshme të komponentëve bazë të procesit mësimor.

##### **2.1.1.1. Vlerësimi i kompetencave në testin e lëndës së Gjuhës Shqipe**

Vlerësimi në testin e **gjuhës shqipe** ka të bëjë me matjen e kompetencave të mëposhtme:

###### **A. Të lexuarit**

- identifikon informacionin më të rëndësishëm;
- tregon brendinë e pjesës që lexon;
- identifikon mesazhin e pjesës që lexon;
- analizon personazhin kryesor;
- gjen idetë dhe mesazhin e pjesës së lexuar duke i ilustruar ato me fragmentet përkatëse.

###### **B. Të shkruarit**

## Vlerësimi i arritjeve të nxënësve të klasës së 5-të

- parashikon zgjidhje, mbyllje të reja të tregimeve sipas imagjinatës;
- rendit sipas rrjedhës logjike paragrafët në hartimin e një teksti;
- shkruan, përshkrime apo tregime të shkurtra ku përdor fjalë të zgjedhura.

### C. Njohuri gjuhësore

- dallon grupin emëror dhe grupin foljor në fjali;
- përcakton klasën e fjalëve të ndryshueshme dhe të pandryshueshme;
- përcakton numrin e emrit;
- përcakton mënyrën e shprehjes së veprimit nga folja;
- shkruan saktë fjalët, shenjat e pikësimit dhe shkronjën e madhe;
- gjen përbërësit e fjalës.

**Tabela 2.1-1** (tabela e specifikimeve sipas strukturës së testit) ilustron linjat dhe nën linjat si dhe përqindjet që i takojnë çdo linje. Ndarja është bërë për qartësimin e aftësive që zotëron nxënësi dhe vlerësimin e tyre. Njëkohësisht është mbajtur parasysh se linjat janë mësuar të integruara me njëra-tjetrën dhe shpesh janë parë të tilla edhe në kërkesat e testit.

Tabela 2.1-1: Shpërndarja e pikëve të testit të gjuhës shqipe sipas linjave

Nr.	Linjat	%	Pikë për linjë	Niveli I -30%	Niveli II-40%	Niveli III-30%
1	Të lexojmë	50%	10	2	6	2
2	Njohuri gjuhësore	35%	7	1	5	1
3	Të shkruajmë	15%	3		2	1
	<b>TOTALI</b>	<b>100%</b>	<b>20</b>			

### 2.1.1.2. Vlerësimi i kompetencave në testin e lëndës së Matematikës

Vlerësimi në testin e matematikës ka të bëjë me matjen e kompetencave të mëposhtme:

#### A. Numri

- kryen mbledhje të dy numrave thyesorë
- shpreh nëpërmjet ilustrimit me figurë pjesën e ngjyrosur me thyese
- përdor kuptimin e numrit dhe të veprimeve me të, për të zgjidhur probleme të thjeshta me të dhëna nga mjedisi rrethues dhe jeta e përditshme;
- rendit dhe dallon vlerën më të madhe dhe më të vogël

#### B. Matja

- kryen veprimet me njësitë e gjatësisë dhe njësitë e masës;
- gjen shumën e këndeve të trekëndëshit
- përdor arsyetimin dhe emerton trupat gjeometrike.

#### C. Algjebër

- zgjidh inekuacionin me jo më shumë se dy veprime.



## Vlerësimi i arritjeve të nxënësve të klasës së 5-të

Tabela 2.1-2 tregon mënyrën e shpërndarjes së pikëve të testit mbi bazën e përqindjes së linjave në programin lëndor si edhe mbi bazën e përqindjes së vështirësive të kërkesave.

Tabela 2.1-2: Shpërndarja e pikëve të testit të matematikës sipas linjave

Nr.	Linjat	%	Pikë për linjë	Niveli I -30%	Niveli II-40%	Niveli III-30%
1	Numri	53%	14	5	6	3
2	Matja	33%	4	1	2	1
3	Algjebra	14%	2	1	1	
	<b>TOTALI</b>	<b>100%</b>	<b>20</b>			

### 2.1.1.3. Vlerësimi i kompetencave në testin e lëndës së Diturisë së Natyrës

Vlerësimi në testin e **diturisë së natyrës** ka të bëjë me matjen e kompetencave të mëposhtme:

#### A. Lëndët dhe vetitë e tyre

- Përshkruan procesin e avullimit.
- Demonstron eksperimentalisht që oksigjeni ndihmon djegien dhe e kundërta.

#### B. Mjedisi fizik

- Shpjegon si krijohen eklipset e Hënës dhe të Diellit dhe bën dallimin midis tyre;
- Demonstron aftësitë për të lidhur një qark të thjeshtë elektrik (p.sh., duke përdorur një bateri, fije dhe llambë).
- Përshkruan krijimin e ditë-natës, si rezultat i rrotullimit të Tokës.

#### C. Gjallesat dhe proceset e jetës

- Krahason qelizën bimore me atë shtazore
- Përshkruan duke përdorur vëzhgimin, ndryshimet e bimëve gjatë ciklit jetësor të tyre (p.sh., që nga fara deri në formimin e lules dhe frutit)
- Identifikon rëndësinë e ushqimit të njeriu

**Tabela 2.1-3** tregon mënyrën e shpërndarjes së pikëve të testit mbi bazën e përqindjes së linjave në programin lëndor si edhe mbi bazën e përqindjes së vështirësive të kërkesave.

Tabela 2.1-3: Shpërndarja e pikëve të testit të diturisë së natyrës sipas linjave

Nr.	Linjat	%	Pikë për linjë	Niveli I - 30%	Niveli II- 40%	Niveli III- 30%
1	Lëndët dhe vetitë e tyre	20%	2	1	1	
2	Mjedisi fizik	38%	4	1	2	1
3	Gjallesat dhe proceset e jetës	42%	4	2	1	1
TOTALI			10	4	4	2

### 2.1.2. Metodologjia dhe instrumentet e vlerësimit

Vlerësimi i njohurive dhe i aftësive të nxënësve u realizua përmes një testi të vetëm, të tipit laps-letër. Kërkesat e testit janë: me alternativa, të hapura, gjysmë të strukturuar dhe të strukturuar. Koha e testimit ishte 90 minuta. Testimi u krye në muajin e fundit të procesit mësimor të vitit shkollor 2016-2017. Testi në total përmban 48 kërkesa, ku Gjuha Shqipe ka 22 pyetje, Matematika 16 pyetje dhe Dituria e Natyrës 10 pyetje. Testi në total është vlerësuar me 60 pikë, nga të cilat 30 pikë i përkasin Gjuhës Shqipe, 20 pikë Matematikës dhe 10 pikë Diturisë së Natyrës.

#### 2.1.2.1. Si u realizua vlerësimi

Testimi u zhvillua në të gjitha shkollat e vendit. Administratorët e testimit ishin mësuesit e arsimit fillor të trajnuar nga QSHA për të kryer këtë proces. Në përfundim të testimit të gjitha testet u administruan dhe u vlerësuan në mjediset e DAR/ZA. Vlerësimi i përgjigjeve të nxënësve është bërë me pikë. Vlerësimi i çdo përgjigjeje të dhënë nga nxënësi për kërkesën përkatëse, mbështetet në formatin e vlerësimit të përgatitur nga QSHA.

#### 2.1.2.2. Pjesëmarrësit në testim

Në këtë testim për klasat e pesta u testuan të gjithë nxënësit e regjistruar në klasën e pestë, në vitin shkollor 2016-2017.

- numri i nxënësve në klasën e pestë ishte **34998**,
- numri i mungesave ishte **250**,

- nxënësit që morën pjesë në testim ishin **34748**.

Vlerësimi i njohurive dhe aftësive të nxënësve lidhur me analizën teknike të testit u bazua në vlerësimin e të gjithë popullatës së nxënësve të klasës së 5-të. Vlerësimi është me bazë klasën e 5-të, pavarësisht moshës së nxënësit që ndjekin klasën e pestë.

**Tabela 2.1-4** jep treguesit e popullatës së nxënësve dhe raportet për ndryshoret e përcaktuara qytet/fshat, publike/private.

Tabela 2.1-4: Treguesit e popullatës

	Popullata e plotë e nxënësve të klasës 5			
	qytet	fshat	publike	Private
Numri	20154	14594	31968	2780
<b>Përqindja</b>	<b>58%</b>	<b>42%</b>	<b>92%</b>	<b>8%</b>

Nga numri total i nxënësve të testuar:

- femrat përbëjnë 58%,
- meshkujt përbëjnë rreth 42%,
- nxënësit e arsimit privat përbëjnë rreth 8%,
- nxënësit e arsimit publik rreth 92%.

### 2.1.2.3. Administrimi i të dhënave

Për të siguruar një proces korrekt të administrimit të të dhënave, u kërkua nga çdo DAR/ZA të caktohej një koordinator rajonal dhe një administrator testi për çdo klasë që do të testohej. Koordinatorët u trajnuan në QSHA për procesin dhe më pas ata trajnuan administratorët e testit. Pas kryerjes së procesit të shumëfishimit të testeve, ato bashke me listat emërore të koduara për çdo shkollë, u paketuan në qese DHL dhe u shpërndanë një ditë para testimit në çdo DAR/ZA. Pas përfundimit të testimit, testet dhe listat emërore të plotësuara me shënimet përkatëse, u dorëzuan në DAR/ZA, ku u administruan dhe u informatizuan. Pas informatizimit të rezultateve u bë lidhja e tyre në bazë të kodit të nxënësit (barkodit) me bazën e të dhënave të shkollave dhe filloi përpunimi statistikor i tyre.

### 2.1.2.4. Instrumentet e vlerësimit

Instrumenti i përdorur për vlerësimin e nxënësve të klasës së 5-të ishte një test i kombinuar. Testi përbante 48 pyetje dhe koha e përcaktuar për zgjidhjen e tyre ishte 90 minuta. Testi i kombinuar përbëhej nga: 22 pyetje të lëndës së gjuhës shqipe, 16 pyetje të lëndës së matematikës dhe 10 pyetje të lëndës dituri natyre.

Raporti 3:2:1 që zënë në test lëndët gjuhë shqipe, matematikë dhe dituri natyre është realizuar në bazë të peshave që kanë këto lëndë në programin mësimor të klasës së 5-të. Në testin e kombinuar gjuha shqipe ka 30 pikë, matematika ka 20 pikë, ndërsa dituria e natyrës ka 10 pikë. Testi u shoqërua me një skemë vlerësimi, ku përgjigjja e mundshme e çdo kërkesë ishte e detajuar. Vlerësimi i përgjigjeve të nxënësve nëpërmjet një skeme të tillë, siguron një vlerësim korrekt dhe uniform nga të gjithë vlerësuesit.

## **2.2. Kapitulli 2: Arritjet e nxënësve**

### **2.2.1. Përpunimi i të dhënave dhe interpretimi i treguesve statistikore**

Pas përfundimit të procesit të testimit, testet e grumbulluara iu nënshtruan procesit të vlerësimit me pikë. Të dhënat e përfutuara nga procesi i vlerësimit të çdo testi të plotësuar u hodhën në një format elektronik Excel.

Përpunimi i të dhënave u realizua nga përdorimi i programit SPSS. Nëpërmjet importimit të databazës në programin SPSS u përftua informacion mbi arritjet e nxënësve dhe vështirësive të kërkesave të testit të kombinuar. Analiza e vështirësisë së testit u bazua në modelin Rasch, sipas të cilit rezultoi se vështirësia e testit ishte nën nivelin mesatar.

Në këtë material statistikat janë shprehur në formë tabelore ose grafike. Treguesit e përdorur janë:

1. mesatarja e arritjeve,
2. shmangia mesatare, që tregon shmangien mesatare të të dhënave nga mesatarja e tyre,
3. gabimi standard, që tregon masën e caktuar të gabimit të vlerësimit,
4. intervali i besueshmërisë, tregon zonën/intervalin në të cilën do të ndodhej rezultati i popullatës, referuar rezultatit të vëzhguar,
5. përqindëshat, që tregojnë vlerën nën të cilën gjenden rezultatet.

Statistikat rreth arritjeve të nxënësve janë shprehur:

## Vlerësimi i arritjeve të nxënësve të klasës së 5-të

---

- në nivel kombëtar,
- në nivel DAR/ZA,
- sipas shkollave publike/private,
- sipas urbanizimit fshat/qytet,
- sipas gjinisë femra/meshkuj.


Paraqitja e këtyre statistikave lejon kryerjen analizave krahasuese ndërmjet kategorive të ndryshme.

### 2.2.2. Arritjet e nxënësve në vlerësimin e klasës së 5-të


Në grafikët 2.2-1, 2.2-2, 2.2-3, jepet shpërndarja e pyetjeve, sipas nivelit të vështirësisë, për testin e kombinuar. Shpërndarja e mëposhtme tregon se vështirësia e testit të kombinuar është nën **nivelin mesatar**.

## Vlerësimi i arritjeve të nxënësve të klasës së 5-të

### Përqindja e nxënësve për përgjigjet e dhëna në çdo pyetje të gjuhës shqipe




Grafiku 2.2-1



Grafiku 2.2-2

## Vlerësimi i arritjeve të nxënësve të klasës së 5-të



Grafiku 2.2-3

Në të djathtë të grafikëve ndodhen pyetjet, sipas shkallës së nivelit të vështirësisë të secilës prej tyre, ndërsa në të majtë të saj kemi shpërndarjen e nxënësve sipas vlerave të arritjeve të tyre. Nga grafikët rezultojnë se:

- kemi nxënës, të cilët kanë arritje shumë të ulëta, në pyetjet e nivelit të tretë,
- kështu në lëndën e gjuhës shqipe, në pyetjen 1, 65.38 % e nxënësve kanë marrë zero pikë,
- në lëndën e gjuhës shqipe, në pyetjen 16, 70.32 % e nxënësve kanë marrë zero pikë,
- ndërsa në lëndën e matematikës, në pyetjen 10, 67.68% e nxënësve janë nxënës që kanë marrë zero pikë.

**Tabela 2.2-1** paraqet pyetjet e testit të kombinuar sipas kodit të pyetjes për çdo lëndë. Për çdo pyetje jepen pikët dhe përqindjet e nxënësve për çdo përgjigje të dhënë. Grafikët 2.2-1, 2.2-2, 2.2-3 janë paraqitja grafike e këtyre të dhënave.



## Vlerësimi i arritjeve të nxënësve të klasës së 5-të


Tabela 2.2-1: Përqindjet e nxënësve për përgjigjet e dhëna për çdo pyetje

Pyetja	Pikët	Përqindja	Pyetja	Pikët	Përqindja
GJ1	0	65.38%	M3	0	7.42%
	1	34.62%		1	92.58%
GJ2	0	16.28%	M4	0	19.30%
	1	83.72%		1	80.70%
GJ3	0	17.20%	M5	0	5.74%
	1	82.80%		1	94.26%
GJ4	0	19.65%	M6	0	6.99%
	1	80.35%		1	93.01%
GJ5	0	15.98%	M7	0	22.62%
	1	84.02%		1	77.38%
GJ6	0	21.88%	M8	0	14.97%
	1	22.00%		1	85.03%
	2	56.12%	M9	0	14.71%
GJ7	0	53.85%		1	85.29%
	1	46.15%	M10	0	67.68%
GJ8	0	19.39%		1	11.66%
	1	80.61%		2	20.66%
GJ9	0	40.78%	M11	0	23.91%
	1	59.22%		1	76.09%
GJ10	0	37.21%	M12	0	36.82%
	1	62.79%		1	63.18%
GJ11	0	17.22%	M13	0	27.92%
	1	28.47%		1	20.88%
	2	54.31%		2	51.20%
GJ12	0	24.44%	M14	0	39.17%
	1	75.56%		1	60.83%
GJ13	0	45.59%	M15	0	54.26%
	1	54.41%		1	45.74%
GJ14	0	34.93%	M16	0	25.07%
	1	18.85%		1	74.93%
	2	46.22%	M17	0	30.92%
GJ15	0	18.03%		1	69.08%
	1	81.97%	M18	0	33.52%
GJ16	0	70.32%		1	66.48%
	1	29.68%	D1	0	16.37%
GJ17	0	5.78%		1	83.63%
	1	94.22%	D2	0	27.26%
GJ18	0	6.82%		1	72.74%
	1	93.18%	D3	0	36.08%
GJ19	0	14.05%		1	63.92%
	1	85.95%	D4	0	25.14%
GJ20	0	23.64%		1	74.86%
	1	28.85%	D5	0	33.92%

### Vlerësimi i arritjeve të nxënësve të klasës së 5-të

	2	47.52%		1	66.08%
GJ21	0	14.03%	D6	0	8.28%
	1	15.69%		1	91.72%
	2	24.62%	D7	0	35.45%
	3	45.66%		1	64.55%
GJ22	0	19.25%	D8	0	21.84%
	1	23.10%		1	78.16%
	2	27.92%	D9	0	29.66%
	3	29.73%		1	70.34%
MI	0	21.37%	D10	0	12.11%
	1	78.63%		1	87.89%
M2	0	28.90%			
	1	71.10%			

Në **Grafiku 2.2-4** paraqet histogramën e shpërndarjes së pikëve të fituara nga nxënësit.



Grafiku 2.2-4: Shpërndarja e pikëve për testin e kombinuar

**Grafiku 2.2-4** tregon që:

- numri më i madh i nxënësve është përqendruar në intervalin 40 – 54 pikë,
- niveli i arritjeve të nxënësve është mbi nivelin mesatar,

Në **Tabelën 2.2-2** janë paraqitur përqindëshat referuar shumës së pikëve të fituara në testim. “Përqindëshi 10” tregon se 10% e nxënësve kanë arritje që nuk e kalojnë vlerën e 25 të pikëve. Po kështu shihet se 95% e nxënësve kanë arritje, vlerat e të cilave shkojnë deri në 57 pikë.

## Vlerësimi i arritjeve të nxënësve të klasës së 5-të

Tabela 2.2-2: Përqindëshat e pikëve të fituara në testim

Përqindëshi	Shuma e pikëve të fituara
5	21.00
10	25.00
25	34.00
50	42.00
65	47.00
75	50.00
90	54.00
95	57.00

**Tabela 2.2-3** jep treguesit e arritjeve të nxënësve të klasës së 5-të për lëndët gjuhë shqipe, matematikë dhe dituri natyre në **nivel kombëtar**, sipas **urbanizimit fshat/qytet** (referuar vendndodhjes së shkollës), sipas **gjinisë femra/meshkuj**, dhe sipas **sistemit publik/privat** të edukimit.

### I. Arritjet sipas urbanizimit qytet/fshat

Nëse analizojmë arritjet e nxënësve në nivel kombëtar sipas elementëve të urbanizimit qytet/fshat të paraqitura në **tabelën 2.2-3**, rezulton se:

- arritjet e nxënësve të fshatit janë më të ulëta se arritjet e nxënësve të qytetit,
- mesatarja e pikëve të fituara nga nxënësit e qytetit rezulton të jetë **6.49 pikë** më e lartë ndaj mesatares së pikëve të nxënësve të fshatit.

### II. Arritjet sipas gjinisë

Nga të dhënat e paraqitura në **tabelën 2.2-3** vërejmë se:

- vajzat kanë rezultate më të larta se djemtë,
- vajzat kanë rezultate më të larta krahasuar me djemtë, si në sistemin publik, po ashtu edhe në sistemin privat.

### III. Arritjet sipas sistemit publik/privat të edukimit.

Të dhënat e **tabelës 2.2-3** tregojnë ekzistencën e diferencave mes arritjeve të nxënësve në dy sistemet arsimore publik e privat, në vendin tonë. Kështu:

- arritjet mesatare të nxënësve në sistemin privat të edukimit janë më të larta se arritjet mesatare të nxënësve në sistemin publik, përkatësisht me **4.53 pikë**.

## Vlerësimi i arritjeve të nxënësve të klasës së 5-të

Tabela 2.2-3: Treguesit e arritjeve të nxënësve sipas elementëve të urbanizimit

<i>Urbanizimi/publike/private</i>	Gjinia	Mesatarja e arritjeve	Shmangia mesatare	Gabimi standard
<b>Total</b>		<b>41</b>	<b>11.07</b>	<b>0.06</b>
	Femra	<b>48.93</b>	<b>7.97</b>	<b>0.26</b>
	Meshkuj	<b>39.58</b>	<b>11.3</b>	<b>0.08</b>
<b>Fshat</b>		<b>35.97</b>	<b>10.79</b>	<b>0.12</b>
	Femra	<b>39.32</b>	<b>10.39</b>	<b>0.12</b>
	Meshkuj	<b>35.97</b>	<b>10.79</b>	<b>0.12</b>
<b>Qytet</b>		<b>42.46</b>	<b>10.86</b>	<b>0.11</b>
	Femra	<b>45.21</b>	<b>9.99</b>	<b>0.11</b>
	Meshkuj	<b>42.46</b>	<b>10.86</b>	<b>0.11</b>
<b>Publike</b>		<b>43.24</b>	<b>10.91</b>	<b>0.12</b>
	Femra	<b>44.75</b>	<b>10.37</b>	<b>0.17</b>
	Meshkuj	<b>41.9</b>	<b>11.2</b>	<b>0.17</b>
<b>Private</b>		<b>47.77</b>	<b>8.71</b>	<b>0.19</b>
	Femra	<b>48.93</b>	<b>7.97</b>	<b>0.26</b>
	Meshkuj	<b>46.75</b>	<b>9.19</b>	<b>0.28</b>


**Grafiku 2.2-6** paraqet mesataren e arritjeve të nxënësve në testin e kombinuar sipas 38 DAR/ZA. Sipas këtij grafiku rezultojnë se:

- Nivelin më të ulët të arritjeve e ka **ZA Librazhd**, respektivisht **29.04 pikë**,
- Nivelin më të lartë të arritjeve e ka **DAR Tiranë**, respektivisht **47.63 pikë**.

Në aneksin 1 jepet renditja e shkollave sipas nivelit të arritjeve.

Arritjet mesatare në nivel kombëtar paraqiten me vijë në ngjyrë të kuqe në grafik.

## Vlerësimi i arritjeve të nxënësve të klasës së 5-të



Grafiku 2.2-6: Arritjeve të nxënësve në testin e kombinuar

**Tabela 2.2-4** paraqet të dhëna në nivel DAR/ZA lidhur me arritjet mesatare të nxënësve gjithsej, të nxënësve që mësojnë në shkollat e fshatit (shih tabela 2.2-5), në shkollat e qytetit (shih tabela 2.2-6), të nxënësve femra (shih tabela 2.2-7) si dhe të nxënësve meshkuj (shih tabela 2.2-8)

Të dhënat e **tabelës 2.2-4** tregojnë se:

- mesataren më të lartë të pikëve e ka **DAR Tirana**, respektivisht **47.63**,
- mesataren më të ulët e ka **ZA Librazhd**, respektivisht **29.04**.
- **njëzetë e pesë DAR/ZA e kanë mesataren më të lartë se mesatarja e pikëve për arritjet e nxënësve në nivel kombëtar (41 pikë), ndërsa trembëdhjetë DAR/ZA e kanë mesataren më të ulët.**

Tabela 2.2-4: Arritjet mesatare të nxënësve në nivel kombëtar

Arritjet e nxënësve sipas DAR/ZA	Mesatarja e arritjeve	Shmangia mesatare	Gabimi standard
<b>Nivel Kombëtar</b>	<b>41</b>	<b>11.07</b>	<b>0.06</b>
<i>BERAT</i>	40.83	11.14	0.31
<i>BULQIZË</i>	36.52	9.18	0.52
<i>DELVINË</i>	37.07	11.11	1.10
<i>DEVOLL</i>	41.35	11.62	0.71
<i>DIBER</i>	37.94	10.69	0.36
<i>DURRËS</i>	38.05	11.11	0.20
<i>ELBASAN</i>	42.19	9.98	0.21
<i>FIER</i>	39.38	10.38	0.24
<i>GJIROKASTËR</i>	38.22	11.86	0.67
<i>GRAMSH</i>	39.33	11.65	0.72
<i>HAS</i>	36.52	9.84	0.68
<i>KAMEZ</i>	40.62	9.86	0.24
<i>KAVAJË</i>	42.12	10.88	0.40
<i>KOLONJË</i>	41.79	9.92	0.93
<i>KORCE</i>	42.05	10.86	0.31
<i>KRUJE</i>	30.20	9.34	0.40
<i>KUÇOVË</i>	36.47	12.56	0.74
<i>KUKES</i>	37.49	9.38	0.35
<i>KURBIN</i>	38.63	11.23	0.47
<i>LEZHE</i>	39.15	10.53	0.37
<i>LIBRAZH</i>	<b>29.04</b>	8.34	0.33
<i>LUSHNJË</i>	43.08	10.52	0.30
<i>MALESI E MADHE</i>	37.27	9.26	0.52
<i>MALLAKASTËR</i>	39.73	10.91	0.59
<i>MAT</i>	36.53	11.53	0.49
<i>MIRDITË</i>	39.07	12.05	0.81
<i>PEQIN</i>	40.64	11.09	0.64
<i>PERMET</i>	39.49	10.67	0.79
<i>POGRADEC</i>	45.59	9.79	0.35
<i>PUKË</i>	43.17	8.41	0.59

**Vlerësimi i arritjeve të nxënësve të klasës së 5-të**

<i>QARKU TIRANË</i>	38.32	10.43	0.25
<i>SARANDË</i>	42.20	11.01	0.51
<i>SHKODËR</i>	41.56	10.71	0.24
<i>SKRAPAR</i>	41.85	12.09	0.97
<i>TEPELENË</i>	39.18	11.03	0.79
<i>TIRANË</i>	<b>47.63</b>	8.89	0.12
<i>TROPOJË</i>	46.49	7.23	0.46
<i>VLORE</i>	41.39	11.81	0.31

**Tabela 2.2-5** paraqet të dhëna lidhur me arritjet mesatare të nxënësve në shkollat e fshatit. Të dhënat e tabelës 2.2-5 tregojnë se:

- mesataren më të lartë të pikëve e kanë **ZA Tropojë dhe ZA Pogradec**, respektivisht **45.58 dhe 44.61**,
- mesataren më të ulët e ka **ZA Librazhd**, respektivisht **28.35**.
- **pesë DAR/ZA e kanë mesataren më të lartë se mesatarja e pikëve për arritjet e nxënësve në nivel kombëtar, ndërsa tridhjetë e dy DAR/ZA e kanë mesataren më të ulët se niveli mesatar kombëtar, në fshat.**

*Tabela 2.2-5: Arritjet mesatare të nxënësve në nivel kombëtar, për shkollat e fshatit*

<i>Arritjet e nxënësve sipas DAR/ZA</i>	Mesatarja e arritjeve	Shmangia mesatare	Gabimi standard
<b>Nivel Kombëtar</b>	<b>35.97</b>	<b>10.79</b>	<b>0.12</b>
<i>BERAT</i>	38.88	10.65	0.40
<i>BULQIZË</i>	34.77	9.08	0.67
<i>DELVINË</i>	33.96	10.56	1.49
<i>DEVOLL</i>	38.66	11.90	0.92
<i>DIBER</i>	34.67	10.05	0.41
<i>DURRËS</i>	34.69	11.12	0.31
<i>ELBASAN</i>	42.02	9.20	0.27
<i>FIER</i>	36.68	9.63	0.31
<i>GJIROKASTËR</i>	34.53	12.94	1.81
<i>GRAMSH</i>	33.84	9.94	0.81
<i>HAS</i>	35.33	8.98	0.76
<i>KAMEZ</i>	38.39	9.55	0.61
<i>KAVAJË</i>	41.02	10.66	0.53
<i>KOLONJË</i>	35.52	8.92	1.34
<i>KORCE</i>	39.14	10.34	0.39
<i>KRUJE</i>	29.99	8.94	0.47
<i>KUÇOVË</i>	31.72	12.06	1.02
<i>KUKES</i>	35.24	8.65	0.43
<i>KURBIN</i>	35.38	11.35	0.74
<i>LEZHE</i>	37.53	10.36	0.46
<i>LIBRAZH</i>	<b>28.35</b>	7.74	0.35
<i>LUSHNJË</i>	40.71	10.32	0.35

Vlerësimi i arritjeve të nxënësve të klasës së 5-të

<i>MALESI E MADHE</i>	35.91	8.84	0.57
<i>MALLAKASTËR</i>	36.02	10.72	0.81
<i>MAT</i>	32.61	10.54	0.63
<i>MIRDITE</i>	34.08	10.44	1.11
<i>PEQIN</i>	39.82	10.96	0.72
<i>PERMET</i>	31.13	7.74	1.61
<i>POGRADEC</i>	44.61	10.12	0.46
<i>PUKË</i>	42.07	8.10	0.75
<i>QARKU TIRANE</i>	38.19	10.48	0.25
<i>SARANDË</i>	38.75	10.42	0.77
<i>SHKODËR</i>	39.76	10.74	0.36
<i>SKRAPAR</i>	32.98	11.43	1.78
<i>TEPELENE</i>	34.69	10.24	1.06
<i>TROPOJE</i>	<b>45.58</b>	6.72	0.52
<i>VLORË</i>	36.27	10.42	0.58

**Tabela 2.2-6** paraqet të dhëna lidhur me arritjet mesatare të nxënësve në shkollat e qytetit. Të dhënat e tabelës tregojnë se:

- mesataren më të lartë të pikëve e ka **ZA Tropojë**, respektivisht **48.42**,
- mesataren më të ulët e ka **ZA Krujë**, respektivisht **30.58**, nga 60 pikë totale të testit.
- **gjysma e DAR/ZA e kanë mesataren më të lartë se mesatarja e pikëve për arritjet e nxënësve në nivel kombëtar, në qytet.**

Tabela 2.2-6: Arritjet mesatare të nxënësve në nivel kombëtar, për shkollat e qytetit

<i>Arritjet e nxënësve sipas DAR/ZA</i>	Mesatarja e arritjeve	Shmangia mesatare	Gabimi standard
<b>Nivel Kombëtar</b>	<b>42.46</b>	<b>10.86</b>	<b>0.11</b>
<i>BERAT</i>	43.35	11.26	0.48
<i>BULQIZË</i>	39.01	8.77	0.78
<i>DELVINË</i>	40.06	10.89	1.51
<i>DEVOLL</i>	45.69	9.74	0.96
<i>DIBER</i>	45.59	7.89	0.49
<i>DURRËS</i>	40.52	10.44	0.25
<i>ELBASAN</i>	42.38	10.76	0.33
<i>FIER</i>	42.06	10.40	0.33
<i>GJIROKASTËR</i>	38.93	11.53	0.71
<i>GRAMSH</i>	46.78	9.47	0.90
<i>HAS</i>	38.78	11.01	1.29
<i>KAMEZ</i>	40.98	9.87	0.25
<i>KAVAJË</i>	43.45	11.02	0.60
<i>KOLONJË</i>	45.73	8.42	1.01
<i>KORCE</i>	45.87	10.33	0.45



Vlerësimi i arritjeve të nxënësve të klasës së 5-të

<i>KRUJE</i>	<b>30.58</b>	10.03	0.72
<i>KUÇOVË</i>	40.97	11.35	0.94
<i>KUKES</i>	40.57	9.48	0.55
<i>KURBIN</i>	41.34	10.42	0.58
<i>LEZHE</i>	41.59	10.32	0.57
<i>LIBRAZHD</i>	31.65	9.92	0.87
<i>LUSHNJE</i>	48.38	8.90	0.45
<i>MALESI E MADHE</i>	41.35	9.36	1.05
<i>MALLAKASTËR</i>	43.72	9.66	0.76
<i>MAT</i>	40.66	11.10	0.68
<i>MIRDITE</i>	42.34	11.95	1.03
<i>PEQIN</i>	43.36	11.17	1.34
<i>PERMET</i>	40.70	10.51	0.83
<i>POGRADEC</i>	47.32	8.95	0.54
<i>PUKË</i>	44.63	8.64	0.92
<i>QARKU TIRANE</i>	42.29	8.10	1.09
<i>SARANDË</i>	44.45	10.81	0.64
<i>SHKODËR</i>	43.02	10.45	0.32
<i>SKRAPAR</i>	45.01	10.70	1.00
<i>TEPELENE</i>	43.35	10.09	1.01
<i>TIRANE</i>	47.63	8.89	0.12
<i>TROPOJE</i>	<b>48.42</b>	7.93	0.89
<i>VLORE</i>	42.90	11.78	0.36

**Tabela 2.2-7** paraqet të dhëna lidhur me arritjet mesatare të nxënësve femra. Të dhënat e tabelës tregojnë se:

- mesataren më të lartë të pikëve e ka **DAR Tirana**, respektivisht **48.69**,
- mesataren më të ulët e ka **ZA Librazhd**, respektivisht **30.36**.
- **njzet DAR/ZA e kanë mesataren më të lartë se mesatarja e pikëve për arritjet e nxënësve në nivel kombëtar, për femra.**

Tabela 2.2-7: Arritjet mesatare të nxënësve në nivel kombëtar, për nxënëset femra

Arritjet e nxënësve sipas DAR/ZA	Mesatarja e arritjeve	Shmangia mesatare	Gabimi standard
<b>Nivel Kombëtar</b>	<b>41.50</b>	<b>7.97</b>	<b>0.26</b>
<i>BERAT</i>	42.59	10.98	0.44
<i>BULQIZË</i>	38.68	8.41	0.69
<i>DELVINË</i>	41.30	9.61	1.28
<i>DEVOLL</i>	43.34	10.96	0.96
<i>DIBER</i>	39.50	10.52	0.52
<i>DURRËS</i>	39.87	10.47	0.28
<i>ELBASAN</i>	42.20	10.08	0.31
<i>FIER</i>	41.64	9.85	0.34
<i>GJIROKASTËR</i>	41.03	10.53	0.87

Vlerësimi i arritjeve të nxënësve të klasës së 5-të

GRAMSH	39.79	11.47	1.01
HAS	38.83	10.29	1.01
KAMEZ	41.88	9.43	0.34
KAVAJË	43.94	10.91	0.57
KOLONJË	42.77	9.95	1.26
KORCE	43.75	10.13	0.41
KRUJE	31.91	8.96	0.58
KUÇOVË	38.27	11.93	0.97
KUKES	39.24	9.27	0.52
KURBIN	40.71	10.39	0.63
LEZHE	41.07	10.52	0.56
LIBRAZHD	<b>30.36</b>	7.82	0.43
LUSHNJE	45.40	9.52	0.39
MALESI E MADHE	39.09	9.32	0.77
MALLAKASTËR	42.19	10.13	0.80
MAT	38.19	10.87	0.71
MIRDITE	41.21	10.69	1.04
PEQIN	42.64	10.84	0.97
PERMET	42.11	10.34	1.15
POGRADEC	47.35	9.26	0.48
PUKË	44.52	8.21	0.86
QARKU TIRANE	40.36	9.98	0.35
SARANDË	44.64	9.96	0.64
SHKODËR	43.05	10.16	0.33
SKRAPAR	43.66	12.27	1.44
TEPELENE	40.14	11.19	1.15
TIRANE	<b>48.69</b>	8.44	0.17
TROPOJE	48.19	6.64	0.63
VLORE	43.24	11.06	0.42

**Tabela 2.2-8** paraqet të dhëna lidhur me arritjet mesatare të nxënësve meshkuj. Të dhënat e tabelës 2.2-8 tregojnë se:

- mesataren më të lartë të pikëve e ka **DAR Tirana**, respektivisht **48.69**,
- mesataren më të ulët e ka **ZA Librazhd**, respektivisht **30.36**,
- **dymbëdhjetë DAR/ZA e kanë mesataren më të lartë se mesatarja e pikëve për arritjet e nxënësve në nivel kombëtar, për meshkuj.**

## Vlerësimi i arritjeve të nxënësve të klasës së 5-të

Tabela 2.2-8: Arritjet mesatare të nxënësve në nivel kombëtar, për nxënësit meshkuj

Arritjet e nxënësve sipas DAR/ZA	Mesatarja e arritjeve	Shmangia mesatare	Gabimi standard
<b>Nivel Kombëtar</b>	<b>39.58</b>	<b>11.3</b>	<b>0.08</b>
<i>BERAT</i>	39.17	11.05	0.43
<i>BULQIZË</i>	34.51	9.43	0.75
<i>DELVINË</i>	31.91	10.70	1.58
<i>DEVOLL</i>	39.49	11.94	1.01
<i>DIBER</i>	36.55	10.66	0.50
<i>DURRËS</i>	36.45	11.42	0.29
<i>ELBASAN</i>	42.18	9.89	0.29
<i>FIER</i>	37.57	10.44	0.32
<i>GJIROKASTËR</i>	35.74	12.44	0.96
<i>GRAMSH</i>	38.89	11.84	1.02
<i>HAS</i>	34.30	8.87	0.85
<i>KAMEZ</i>	39.57	10.10	0.33
<i>KAVAJË</i>	40.30	10.56	0.55
<i>KOLONJË</i>	40.62	9.86	1.37
<i>KORCE</i>	40.39	11.28	0.45
<i>KRUJE</i>	28.88	9.42	0.53
<i>KUÇOVË</i>	34.49	12.98	1.11
<i>KUKES</i>	36.04	9.24	0.47
<i>KURBIN</i>	36.72	11.64	0.67
<i>LEZHE</i>	37.75	10.32	0.47
<i>LIBRAZHD</i>	<b>27.57</b>	8.66	0.50
<i>LUSHNJE</i>	41.06	10.93	0.42
<i>MALESI E MADHE</i>	35.72	8.95	0.68
<i>MALLAKASTËR</i>	37.55	11.14	0.83
<i>MAT</i>	35.28	11.88	0.67
<i>MIRDITE</i>	37.15	12.90	1.19
<i>PEQIN</i>	39.22	11.08	0.84
<i>PERMET</i>	37.39	10.51	1.05
<i>POGRADEC</i>	44.01	10.00	0.50
<i>PUKË</i>	42.09	8.44	0.79
<i>QARKU TIRANE</i>	36.60	10.50	0.34
<i>SARANDË</i>	39.57	11.49	0.77
<i>SHKODËR</i>	40.22	11.01	0.34
<i>SKRAPAR</i>	40.25	11.77	1.29
<i>TEPELENE</i>	38.26	10.85	1.09
<i>TIRANE</i>	<b>46.69</b>	9.16	0.17
<i>TROPOJE</i>	45.12	7.42	0.63
<i>VLORE</i>	39.63	12.24	0.46

## Vlerësimi i arritjeve të nxënësve të klasës së 5-të

**Tabela 2.2-9** paraqet një analizë më të detajuar të shumës së pikëve të fituara në testin e kombinuar, sipas niveleve me pikët respektive të mëposhtme.

Tabela 2.2-9: Shuma e pikëve të fituara në testin e kombinuar sipas niveleve

Nivelet e arritjes	Niveli 0	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3	Niveli 4	Niveli 5	Niveli 6
<b>Pikët përkatëse të nivelit</b>	<b>0-12</b>	<b>13-22</b>	<b>23-30</b>	<b>31-37</b>	<b>38-46</b>	<b>47-55</b>	<b>56-60</b>
<b>Niveli i njohurive që zotërohet</b>	i pamjaftueshëm	minimal	nën mesatar	mesatar	mbi mesatar	i lartë	shumë lartë

**Tabela 2.2-10** jep shpërndarjen e nxënësve sipas 6 niveleve bazë të zotërimit të njohurive për të gjitha nivelet e arritjeve.


Tabela 2.2-10: Shpërndarja e nxënësve sipas niveleve

Nivelet e arritjes	Niveli 0	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3	Niveli 4	Niveli 5	Niveli 6
<b>Pikët</b>	<b>0-12</b>	<b>13-22</b>	<b>23-30</b>	<b>31-37</b>	<b>38-46</b>	<b>47-55</b>	<b>56-60</b>
<b>Totali</b>	<b>0.80%</b>	<b>5.83%</b>	<b>11.96%</b>	<b>16.31%</b>	<b>28.83%</b>	<b>28.97%</b>	<b>7.31%</b>
<i>Femra</i>	0.27%	1.97%	4.50%	6.95%	13.67%	15.45%	4.23%
<i>Meshkuj</i>	0.53%	3.86%	7.46%	9.36%	15.16%	13.52%	3.08%
<b>Fshat</b>	<b>0.52%</b>	<b>3.60%</b>	<b>7.46%</b>	<b>9.31%</b>	<b>13.25%</b>	<b>8.90%</b>	<b>1.16%</b>
<i>Femra</i>	0.19%	1.18%	2.85%	4.16%	6.64%	5.04%	0.73%
<i>Meshkuj</i>	0.33%	2.42%	4.61%	5.15%	6.61%	3.86%	0.43%
<b>Qytet</b>	<b>0.28%</b>	<b>2.23%</b>	<b>4.50%</b>	<b>7.00%</b>	<b>15.58%</b>	<b>20.07%</b>	<b>6.15%</b>
<i>Femra</i>	0.08%	0.79%	1.65%	2.79%	7.03%	10.41%	3.50%
<i>Meshkuj</i>	0.20%	1.44%	2.85%	4.21%	8.55%	9.66%	2.65%
<b>Privat</b>	<b>0.00%</b>	<b>0.09%</b>	<b>0.23%</b>	<b>0.43%</b>	<b>1.37%</b>	<b>2.93%</b>	<b>1.03%</b>
<i>Femra</i>	0.00%	0.04%	0.06%	0.17%	0.57%	1.46%	0.56%
<i>Meshkuj</i>	0.00%	0.05%	0.17%	0.26%	0.80%	1.47%	0.47%
<b>Publik</b>	<b>0.80%</b>	<b>5.74%</b>	<b>11.73%</b>	<b>15.88%</b>	<b>27.46%</b>	<b>26.04%</b>	<b>6.28%</b>
<i>Femra</i>	0.27%	1.93%	4.44%	6.78%	13.10%	13.99%	3.67%
<i>Meshkuj</i>	0.53%	3.81%	7.29%	9.10%	14.36%	12.05%	2.61%


- Numri më i madh i nxënësve i përket nivelit 5 me 28.97%.
- Vetëm 7.31% kanë marrë 56-60 pikë, që i përket nivelit 6, i cili është niveli më i lartë i arritjeve.
- Në nivelin 0 janë 0.80% e nxënësve dhe në nivelin 1 janë 5.83% e tyre.

## Vlerësimi i arritjeve të nxënësve të klasës së 5-të


Të dhënat e tabelës 2.2-10 janë paraqitur grafikisht në grafikët 2.2-7, 2.2-8, 2.2-9 , të cilat tregojnë ndryshueshmërinë e përqindjes së nxënësve që i përkasin niveleve të arritjeve për secilën kategori të nxënësve.



Grafiku 2.2-7: Shpërndarja e arritjeve të nxënësve sipas niveleve



Grafiku 2.2-8: Arritjet e nxënësve femra sipas niveleve



Grafiku 2.2-9: Arritjet e nxënësve meshkuj sipas niveleve

### 2.2.3. Arritjet e nxënësve në testin e Gjuhës Shqipe

#### 1.1. Pikët mesatare sipas DAR/ZA

**Tabela 2.2-11** jep informacion rreth numrit të nxënësve, për të cilët janë nxjerrë të dhënat statistikore, mesataren kombëtare të arritjeve dhe gabimin standard dhe tregues të tjerë statistikorë.

Tabela 2.2-11: Tregues statistikor

Numri i nxënësve	Mesatarja	Median	Gabimi standard i mesatares	Devijimi standard	Varianca
<b>34748</b>	20.06	21.00	0.03	5.95	35.37

- Pjesëmarrja në testim ishte **99.3%**, ndërsa përqindja e mungesave 0.7%.
- Mesatarja e pikëve për arritjet e nxënësve është **20.06**, nga 30 pikë që i përkisnin lëndës gjuhë Shqipe
- Vlera e mesme e arritjeve është 21.
- Gabimi standard i mesatares, i cili tregon se sa afër është mesatarja e studimit me mesataren e popullsisë, është 0.03.
- Devijimi standard i ulët do të thotë se pikat e të dhënave janë të grupuara shumë afër të njëjtës vlerë (mesatare), ndërsa devijimi standard i lartë nënkupton se të dhënat janë të vendosura në një grup më të madh vlerash. Në rastin tonë devijim standard 5.95 tregon se shumica e nxënësve kanë marrë pikët në intervalin 14 deri në 25.

Përfundimet e mësipërme u nxorën nga perpunimi i rezultateve të 34748 nxënësve që dhanë testin e gjuhës shqipe për klasën e 5-të.

**Tabela 2.2-12** jep informacion rreth arritjeve mesatare të nxënësve për çdo DAR/ZA. Të dhënat e Tabelës 2.2-12 tregojnë se:

- mesataren më të lartë të pikëve e ka **DAR Tirana**, respektivisht **23.62**,
- mesataren më të ulët e ka **ZA Librazhd**, respektivisht **15.32**.
- **njëmbëdhjetë DAR/ZA e kanë mesataren më të lartë se mesatarja e pikëve për arritjet e nxënësve në nivel kombëtar**

Tabela 2.2-12: Arritjeve mesatare të nxënësve për çdo DAR/ZA

DAR/ZA	Mesatarja	Gabimi standard i mesatares	Devijimi standard	Median	Varianca
<i>Në nivel kombëtar</i>	20.06	0.03	5.95	21	35.37
<i>BERAT</i>	19.78	0.50	5.76	20.00	33.17
<i>BULQIZË</i>	16.80	0.32	5.54	17.00	30.73
<i>DELVINË</i>	17.92	0.60	6.06	19.00	36.75
<i>DEVOLL</i>	18.93	0.40	6.63	20.00	43.93
<i>DIBER</i>	17.23	0.20	6.01	18.00	36.07
<i>DURRËS</i>	18.65	0.11	5.98	19.00	35.77
<i>ELBASAN</i>	20.48	0.12	5.63	21.00	31.73
<i>FIER</i>	18.76	0.13	5.66	19.00	32.01
<i>GJIROKASTËR</i>	19.87	0.34	5.97	21.00	35.65
<i>GRAMSH</i>	18.69	0.39	6.28	19.00	39.45
<i>HAS</i>	16.24	0.36	5.40	16.00	29.20
<i>KAMEZ</i>	19.44	0.13	5.46	20.00	29.84
<i>KAVAJË</i>	19.94	0.20	5.30	21.00	28.14
<i>KOLONJË</i>	20.78	0.51	5.48	21.00	30.03
<i>KORCE</i>	20.09	0.17	6.01	21.00	36.16
<i>KUÇOVË</i>	18.60	0.42	7.02	20.00	49.28
<i>KUKES</i>	17.86	0.20	5.24	18.00	27.49
<i>KURBIN</i>	17.93	0.24	5.67	19.00	32.09
<i>LEZHE</i>	19.07	0.20	5.83	20.00	34.03
<i>LIBRAZHD</i>	<b>15.32</b>	0.16	5.17	16.00	38.07
<i>LUSHNJË</i>	19.98	0.56	6.38	21.00	40.67
<i>MALESI E MADHE</i>	17.28	0.30	5.29	17.00	28.03
<i>MALLAKASTËR</i>	19.05	0.33	6.10	20.00	37.25
<i>MAT</i>	17.32	0.26	6.17	18.00	38.07
<i>MIRDITË</i>	20.02	0.42	6.19	20.50	38.32
<i>PEQIN</i>	18.43	0.35	6.01	19.00	36.11
<i>PERMET</i>	19.71	0.42	5.57	20.00	31.03
<i>POGRADEC</i>	21.94	0.19	5.30	23.00	28.08
<i>PUKË</i>	20.61	0.36	5.14	21.00	26.45
<i>SARANDË</i>	20.81	0.29	6.29	22.00	39.56
<i>SHKODËR</i>	20.27	0.12	5.36	21.00	28.78
<i>SKRAPAR</i>	20.22	0.50	6.20	22.00	38.45

**Vlerësimi i arritjeve të nxënësve të klasës së 5-të**

<i>TEPELENE</i>	18.85	0.42	5.84	19.00	34.11
<i>TIRANE</i>	<b>23.62</b>	0.07	4.86	25.00	23.64
<i>QARKU TIRANE</i>	18.71	0.14	5.80	19.00	33.59
<i>TROPOJE</i>	21.73	0.29	4.70	23.00	22.07
<i>VLORE</i>	20.53	0.17	6.18	22.00	38.20

**Tabela 2.2-13** jep informacion rreth arritjeve të nxënësve në testin e Gjuhës Shqipe në **nivel kombëtar**, sipas **urbanizimit fshat/qytet**, sipas **gjinisë femra/meshkuj**, dhe sipas **sistemit publik/privat** të edukimit.

### **I. Arritjet sipas urbanizimit qytet/fshat**

Nëse analizojmë arritjet e nxënësve në nivel kombëtar sipas elementëve të urbanizimit qytet/fshat të paraqitura në Tabelën 2.2-13, rezulton se:

- arritjet e nxënësve të fshatit janë më të ulëta se arritjet e nxënësve të qytetit.
- mesatarja e pikëve të fituara nga nxënësit e qytetit rezulton të jetë **3.48 pikë** më e lartë ndaj nxënësve të fshatit.

### **II. Arritjet sipas gjinisë**

Nëse analizojmë arritjet e nxënësve sipas gjinisë, të paraqitura në tabelën 2.2-132, rezulton se:

- vajzat kanë rezultate më të larta ndaj djemve.
- vajzat kanë rezultate më të larta krahasuar me djemtë, si në sistemin publik, po ashtu edhe në sistemin privat.

### **III. Arritjet sipas sistemit publik/privat të edukimit.**

Të dhënat e **Tabelës 2.2-313** tregojnë ekzistencën e diferencave mes arritjeve të nxënësve në dy sistemet arsimore publik e privat, në vendin tonë. Kështu:

- arritjet mesatare të nxënësve në sistemin privat të edukimit janë më të larta se arritjet mesatare të nxënësve në sistemin publik, përkatësisht me **1.59 pikë**.



## Vlerësimi i arritjeve të nxënësve të klasës së 5-të

Tabela 2.2-13: Arritjet e nxënësve në nivel kombëtar sipas urbanizimit

Urbanizimi/ publik/privat	Gjinia	Mesatarja e arritjeve	Shmangia mesatare	Gabimi standard
<b>Total</b>		20.06	5.95	0.03
	Femra	21.09	5.61	0.05
	Meshkuj	19.14	6.08	0.05
<b>Fshat</b>		18.03	5.86	0.05
	Femra	19.15	5.59	0.07
	Meshkuj	17.04	5.91	0.07
<b>Qytet</b>		21.51	5.57	0.04
	Femra	22.48	5.21	0.06
	Meshkuj	20.65	5.74	0.06
<b>Publike</b>		21.77	5.61	0.07
	Femra	22.73	5.25	0.09
	Meshkuj	20.91	5.79	0.09
<b>Private</b>		23.36	4.64	0.10
	Femra	24.06	4.26	0.14
	Meshkuj	22.73	4.87	0.15

Për të pasur të dhëna krahasuese, nxënësit u kategorizuan sipas katër niveleve të arritjeve, si në **tabelën 2.2-14**.

Tabela 2.2-14: Arritjet sipas niveleve

Niveli	Niveli 0 (Dobët)	Niveli 1 (Mjaftueshëm)	Niveli 2 (Mirë)	Niveli 3 (Shumë mirë)
<b>Pikët</b>	<b>0-8 pikë</b>	<b>9-17 pikë</b>	<b>18-25 pikë</b>	<b>26-30 pikë</b>
<b>Nr. i nxënësve</b>	<b>1401</b>	<b>9153</b>	<b>16326</b>	<b>6868</b>
<b>%</b>	<b>4.15%</b>	<b>27.12%</b>	<b>48.38%</b>	<b>20.35%</b>

